



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 1 shkurt 2021  
Nr. ref.:1698/21

## VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI132/20

Parashtrues

**Qamile Murtezi - Salihu**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar  
të autoritetit publik**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Qamile Murtezi-Salihu nga fshati Bresalc, Komuna e Gjilanit (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e kërkesës nuk ka specifikuar aktin e autoritetit publik që konteston para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së një akti të paspecifikuar të autoritetit publik përmes së cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara përmes neneve 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 7 shtator 2020, parashtruesja e kërkesës përmes postës e dorëzoi një shkresë në Gjykatë.
6. Më 22 shtator 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 29 shtator 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Gjykata gjithashtu kërkoi nga parashtruesja e kërkesës që të (i) plotësojë formularin zyrtar të Gjykatës; (ii) qartësojë në kërkesë se cilin akt të autoritetit publik e konteston para Gjykatës; (iii) të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri kushtetuese pretendon se i janë shkelur përmes aktit të kontestuar; dhe (iv) dorëzojë të gjitha vendimet relevante të organeve kompetente në lidhje me kërkesën e saj.
8. Më 13 tetor 2020, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin zyrtar, por i cili nuk ishte i plotësuar me të gjitha informatat përkatëse. Gjithashtu, në formularin e dorëzuar nuk ishte saktësuar akti i autoritetit publik i cili kontestohet para Gjykatës, por ishte bashkangjitur një shkresë e 7 korrikut 2020 e cila i ishte adresuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS).

9. Më 11 nëntor 2020, Gjykata i dërgoi edhe një shkresë parashtrueses së kërkesës, duke i kërkuar edhe një herë të gjitha informatat e kërkuara përmes letrës fillestare të 29 shtatorit 2020.
10. Më 23 nëntor 2020, parashtruesja e kërkesës në Gjykatë dorëzoi dokumente shtesë si në vijim: (i) formularin e 7 tetorit 1982 mbi sigurimin pensional dhe invalidor të Ndërmarrjes Shoqërore “28 Nëntori” në Gjilan (në tekstin e mëtejme: N.Sh. “28 Nëntori”); (ii) Vendimin e N.Sh. “28 Nëntori” përmes të cilit ishte caktuar pushimi vjetor në kohëzgjatje prej 1 gushtit 1986 deri më 1 shkurt 1987; (iii) një kopje të letërnjoftimit; (iv) një kopje të evidencës së punëtorëve nga libri amë i punonjësve të N.Sh. “28 Nëntori”; si dhe (v) një përgjigje të DHPGJS-së të 10 korrikut 2020.
11. Më 20 janar 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

### **Përmbledhja e fakteve**

12. Bazuar në shkresat e lëndës të dorëzuara nga parashtruesja e kërkesës, rezulton se ajo kishte krijuar marrëdhënie pune me N.Sh. “28 Nëntori” më 13 korrik 1982.
13. Në një datë të pasaktësuar në këto shkresa, rezulton se N.Sh. “28 Nëntori” u privatizua. Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) përpiloi listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar nga njëzetpërqind (20%) e privatizimit të N.Sh. “28 Nëntori”. Parashtruesja e kërkesës nuk ishte pjesë e kësaj liste. Afati i ankesave para DHPGJS-së përkitazi me këtë listë, ishte 14 qershori 2014.
14. Më 7 korrik 2020, parashtruesja e kërkesës i kishte dërguar një letër DHPGJS-së, në të cilën kishte theksuar se *“I drejtohem Agjencionit Kosovar të Privatizimit që të shqyrtojë kërkesën time, lidhur me 20% të likuidimit të GJ1098, NSH “28 nëntori” (ish “16 nëntori”), pasi kam qenë në marrëdhënie të punës në këtë ndërmarrje shoqërore”*.
15. Më 10 korrik 2020, DHPGJS i dërgoi një njoftim parashtrueses së kërkesës në të cilin, ndër tjerash, kishte theksuar si në vijim: i) procedurat gjyqësore në lidhje me listën e punëtorëve me të drejta legjitime për përfitimin nga njëzetpërqind (20%) e të ardhurave nga privatizimi i N.Sh. „28 Nëntori” kanë përfunduar në të dy shkallët e vendimmarrjes; (ii) afati i fundit për paraqitjen e kërkesave/ankesave në DHPGJS në lidhje me listën e punëtorëve të kësaj ndërmarrje ka qenë data 14 qershor 2014; dhe (iii) *“në lidhje me shkresën tuaj nuk mund të ndërmerret kurrfarë veprimi juridik dhe nuk mund të regjistrohet si lëndë gjyqësore, ngase lidhur me listën e punëtorëve të ndërmarrjes tuaj për përfitim nga 20% afati për ankesa ka skaduar kaherë”*.

### **Pretendimet e parashtrueses së kërkesës**

16. Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj themelore të garantuara përmes neneve 7 [Vlerat], 21 [Parimet e

Përgjithshme], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Ajo nuk ka specifikuar para Gjykatës aktin e autoritetit publik përmes të cilit i janë shkelur këto të drejta.

17. Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës thekson se (i) “me këto veprime që janë bërë nga përfaqësuesi i sindikatës së NSH “28 Nëntori” dhe nga AKP është bërë shkelje e neneve 7, 21, 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës në dëmin tim”; dhe (ii) “sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, neni 10.3 të gjithë që kanë pasur mbi 3 (tri) vite pune, kanë të drejtë për 20% nga privatizimi. Me këtë veprim është bërë diskriminimi personal, dhe është shkelur ligji... . ... të gjithë të barabartë para ligjit”.
18. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata “që të jem pjesëmarrëse në 20% sikur punëtorët tjerë të ndërmarrjes “28. Nëntori” dhe të me paguhet 20%”.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

19. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesja i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
20. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
[...]  
(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
21. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale) dhe 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

#### Neni 47 (Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”  
[...].*

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

22. Në kontekst të dispozitave të lartcekura, Gjykata thekson se bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 1 të nenit 47 dhe nenin 48 të Ligjit, palët para Gjykatës, duhet të kontestojnë një akt të një autoriteti publik. Për më tepër, bazuar në nenin 48 të Ligjit si dhe pikën d) të paragrafit 1 të Rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, përpos specifikimit të aktit konkret të autoritetit publik i cili kontestohet, palët janë gjithashtu të detyruara që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore pretendojnë se u janë cenuar dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që parashtruesja e kërkesës, përkundër kërkesave të Gjykatës për sqarim, nuk ka sqaruar para Gjykatës (i) as aktin e autoritetit publik të cilin e konteston; dhe (ii) as nuk ka paraqitur dhe sqaruar në mënyrë adekuate faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
23. Gjykata rikujton që një shkresë e parashtrueses së kërkesës është pranuar më 7 shtator 2020. Duke marrë parasysh që kërkesa nuk ishte e kompletuar, më 29 shtator 2020, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit dhe pikat (f) dhe (g) të paragrafit (2) të rregullit 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve) të Rregullores së punës, Gjykata i kërkoi parashtrueses së kërkesës, përveç tjerash, që të plotësojë kërkesën e saj, duke: (i) specifikuar aktin/et e autoriteteve publike të cilat i konteston; (ii) qartësuar saktësisht pretendimet e saj për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë; dhe (iii) dorëzuar kopjet e dokumenteve dhe informatave tjera që mbështesin pretendimet e saj. Më 13 tetor 2020, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar, por nuk adresoj të gjitha kërkesat e Gjykatës. Për pasojë, kjo e fundit iu drejtua edhe një herë parashtrueses së kërkesës me kërkesën për sqarimet e nevojshme, dhe posaçërisht në lidhje me aktin e kontestuar të autoritetit publik. Më 23 nëntor 2020, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatë disa shkresa shtesë të cilat janë specifikuar më lart, por edhe më tej, nuk adresoi kërkesat e Gjykatës.
24. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet rregullit 35 (5) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35  
(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

*“(5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën.”*

[...]

25. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës, i mundëson Gjykatës që të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër nëse, ndër të tjera, kërkesa e një parashtruesi është e paplotë dhe e paqartë, përkundër kërkesave të Gjykatës për të plotësuar dhe qartësuar kërkesën përkatëse. Gjykata i është drejtuar parashtrueses së kërkesës dy herë me një kërkesë të tillë, pa sukses.
26. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, është e paqartë (i) cilin akt të autoritetit publik parashtruesja e kërkesës e konteston para Gjykatës; (ii) cilat janë pretendimet e parashtrueses së kërkesës për cenimin e të drejtave dhe lirive të saj kushtetuese; dhe (iii) bazuar në shkresat e lëndës dhe përmbajtjen e tyre, faktet e rastit janë të pakuptueshme.
27. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak se është e paplotë dhe e paqartë, siç është përcaktuar në paragrafin (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës.
28. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata i deklaron këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesit përkatës. (Shih, rastet e Gjykatës, KI89/18, me parashtrues *Agim Jashari*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 27 nëntorit 2018, paragrafi 29; KI74/18, me parashtrues *Gëzim Murati*, Vendimi për refuzimin e kërkesës, i 3 dhjetorit 2018, paragrafi 26; KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20, me parashtrues *Hilmi Aliu dhe Të Tjerët*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 11 nëntorit 2020, paragrafi 33; dhe KI90/20, me parashtrues *Arben Boletini*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 25 nëntorit 2020, paragrafi 25).
29. Prandaj dhe përfundimisht, në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22, 47 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 20 janar 2021, njëzëri:

### VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

*Gresa Caka-Nimani*  
Gresa Caka-Nimani

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

*Arta Rama-Hajrizi*  
Arta Rama-Hajrizi

